

V E N D I M
Nr.301 datë 14.6.1993

**PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT "PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN
E PRONAVE ISH-PRONARËVE"**

Në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijohet Komiteti shtetëror i kthimit dhe i kompensimit të pronave ish-pronarëve me përbërje sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Komiteti shtetëror i kthimit dhe i kompensimit të pronave ish-pronarëve ka këto detyra e të drejta:

a) Evidencohen pretendimet e ish-pronarëve për probleme që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj.

b) Bën mbledhje jo më rrallë se një herë në muaj, shqyrton problemet e ngritura dhe harton e propozon në Këshillin e Ministrave akte të reja ose plotësime në aktet ekzistuese ligjore e nënligjore.

c) Bën drejtimin metodik të veprimtarisë së komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe e bashki, ndjek procesin e kthimit të pronave dhe raporton periodikisht në Këshillin e Ministrave për ecurinë e zbatimit të këtij ligji.

ç) Jep përgjigje dhe u bën sqarimet përkatëse personave të interesuar për probleme që përmban ligji.

Komiteti e zhvillon veprimtarinë e tij pranë Këshillit të Ministrave. Për kryerjen e veprimeve administrative të tij punojnë me shkëputje nga puna 2 veta (njëri specialist-jurist dhe një arkivist-sekretar-daktilografist).

2. Në të gjitha rrethet e vendit, me vendim të këshillit të rrethit e në të gjithë bashkitë me vendim të këshillit të bashkisë, brenda datës 30 qershor 1993, ngrihen komisionet për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve.

a) Komisionet kanë këto detyra e të drejta themelore:

- Konfirmojnë të drejtën e pronësisë ish-pronarëve, duke lëshuar dokumentin përkatës për njohjen, masën dhe mënyrat e kthimit ose të kompensimit të saj.

- Kontrollonjë vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin ish-pronarët dhe e ballafaqojnë atë me aktet ligjore e nënligjore që kanë shërbyer për shtetëzimin, konfiskimin ose shpronësimin e ish-pronarëve.

- Verifikojnë ose llogaritin detyrimet financiare që lindin ndërmjet shtetasve dhe shtetit në procesin e kthimit ose të kompensimit të pronave dhe urdhërojnë organet financiare në rreth e në bashki të ekzekutojnë plotësimin e tyre në përputhje me vendimin që ka marrë komisioni.

- Ish-pronari, për çdo kërkesë të paraqitur pranë komisionit paguan një tarifë shërbimi në masën 2000 lekë, e cila do të përdoret për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve që bëhen në këtë proces.

- Miratojnë listën e ekspertëve, të cilët vlerësojnë vleftën e shpenzimeve të bëra në objekt për ndryshime në strukturë, shtesa anësore, shtesa kati etj., si dhe vleftën e dëmit të shkaktuar nga keqpërdorimi i ndërtesave.

- Urdhërojnë institucionin që ka në administrim pronën shtetërore, të paraqesë dokumente që komisioni i gjykon të nevojshme.

- Në përputhje me ligjin e në bazë të dokumentacionit përkatës përcaktojnë rastet kur ish-pronarët nuk përfitojnë kthim ose kompensim prone.

- Evidencojnë pretendimet e ish-pronarëve që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj, dhe ia paraqesin komitetit shtetëror të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve.

- Komisionet e rretheve mbulojnë veprimtarinë e kthimit e të kompensimit të pronave ish-pronarëve në komuna, kurse ato të bashkive në bashkitë përkatëse.

b) Përbërja e komisioneve për rrethet të jetë 5 veta, si vijon:

Si rregull me funksionin

- | | |
|--------------------------------------|------------------------------------|
| 1. Kryetar komisioni | - sekretari i këshillit të rrethit |
| 2. Nënkyetari | - jurist ose ekonomist |
| 3. Specialistë | - ekonomist ose jurist |
| 4. Specialistë | - nga kadastra |
| 5. Arkivist-sekretar-daktilografist. | |

Në komision të jenë me shkëputje nga puna deri në një vit 3 veta (nënkyetari, specialisti ekonomist ose jurist dhe arkivist-sekretar-daktilografist).

Në përbërjen e komisionit të Bashkisë së Tiranës, veç sa sipër, ka edhe 3 specialistë të tjerë me shkëputje nga puna (jurist, ekonomist, arkivist). Funksioni i arkivistit në këtë rast veçohet nga sekretar-daktilografist. Gjithashtu në përbërjen e komisionit pa shkëputje nga puna bën pjesë edhe një specialist nga dega e agjencisë së privatizimit.

Përbërja e komisionit për bashkitë Shkodër, Durrës, Elbasan, Kavajë, Lushnjë, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, të jetë me 8 veta, si vijon:

Si rregull me funksionin

- | | |
|-------------------------------------|--|
| 1. Kryetar komisioni | - sekretar i këshillit të bashkisë |
| 2. Nënkyetar | - jurist ose ekonomist |
| 3. Specialist | - ekonomist ose jurist |
| 4. Specialist | - inxhinier nga urbanistika |
| 5. Specialist | - nga dega e agjencisë së privatizimit (ekonomist) |
| 6. Specialist | - financier |
| 7. Specialist | - nga kadastra |
| 8. Arkivist-sekretar-daktilografist | |

Në komision të jenë me shkëputje nga puna deri në 1 vit 4 veta (nënkyetari, ekonomisti ose juristi, ekonomisti financier dhe arkivist-sekretar-daktilografisti).

Përbërja e komisioneve për bashkitë e tjera të jetë me 6 veta.

Si rregull me funksionin

- | | |
|-------------------------------------|---|
| 1. Kryetar komisioni | - sekretar i këshillit të bashkisë |
| 2. Nënkyetar | - jurist ose ekonomist |
| 3. Specialist | - ekonomist ose jurist |
| 4. Specialis | t- nga kadastra |
| 5. Specialist | - nga dega e agjencisë së privatizimit(ekonomist) |
| 6. Arkivist-sekretar-daktilografist | |

Në komision të jenë me shkëputje nga puna deri në 1 vit 3 veta (nënkyetari, ekonomisti ose juristi dhe arkivist-sekretar-daktilografisti).

Personave të shkëputur nga puna u ruhet vendi i punës për kohën që do të punojnë pranë komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave.

c) Anëtarët e komisionit, përveç pagës, marrin edhe një shpërblim plotësues mujor:

1. Kryetari dhe anëtarët e komisionit pa shkëputje nga puna 2200 lekë.

2. Nënkyetari dhe anëtarët e komisionit me shkëputje nga puna 2200 lekë.

3. Pagat e anëtarëve të komisionit me shkëputje nga puna caktohen në bazë të vendimit nr.393, datë 3.9.1992.

Shpërblimi i parashikuar në shkronjën "c", pika 1, shërben edhe për kryetarin e anëtarët e komitetit shtetëror të kthimit e kompensimit të pronave, kurse për punonjësit me shkëputje nga puna veprohet sipas kriterëve të përcaktuara në shkronjën "c", pikat 2 e 3.

ç) Në zbatim të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", shteti vë në dispozicion të komisioneve 15 milionë lekë për periudhën qershor-dhjetor 1993 nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit. Ndarja e fondeve për çdo rreth e bashki si dhe për komitetin shtetëror të kthimit

dhe kompensimit të pronave, bëhet nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë. Këto fonde përdoren për pagat dhe shpenzime të tjera administrative për këtë qëllim. Pagesa që bëjnë ish-pronarët në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë komisioneve të rretheve e bashkive, vihen gjithashtu në dispozicion të këtyre të fundit dhe përdoren vetëm për mbulimin e shpenzimeve që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurave për rikthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

3. Vlerësimi i truallit për efekt të nenit 17 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", do të bëhet mbi bazën e të njëjtave kritere të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.364, datë 5.10.1991, ose nr.305, datë 20.7.1992, për llogaritjen e qirasë së tokës, në vartësi të kohës së privatizimit të lokalit.

Niveli i tarifave për pikat 1/a, 1/b e 1/c, sipas të cilave përcaktohet çmimi i tokës, zgjidhet në varësi nga statusi që ka pronari i lokalit, pra, nëse është vendas, vendas që bashkëpunon me të huajt, është nga diaspora ose i huaj.

Madhësia e pjesës së pronarit të lokalit është e barabartë me çmimin e paguar nga ai në momentin e kalimit nga pronë private, e vërtetuar me aktin e blerjes. Në të përfshihet vetëm vlefata e godinës dhe e mjeteve të pandashme me të, siç janë instalimet elektrike, hidraulike, higjieno-sanitare.

4. Në kontratën që lidhet ndërmjet ish-pronarit dhe entit publik që përdor një ndërtesë për qëllime publike, në rastin kur ajo nuk është shembur dhe nuk është blerë nga shteti (neni 7 i ligjit) çmimi i qirasë caktohet mbi bazën e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.282, datë 25.6.1992 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe të nivelit të qirasë për objektet që u jepen në përdorim të tretëve". Qiraja llogaritet për të gjithë sipërfaqen e ndërtimit. Qiraja e truallit rreth ndërtesës, që është pjesë funksionale e saj dhe që përfshihet në kontratën e qirasë, llogaritet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.305, datë 20.7.1992. Çmimi i qirasë konvertohet në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të valutës në fillim të çdo muaji.

5. Seksionet e urbanistikës në rrethe e në bashkinë e Tiranës të venë në dispozicion të të interesuarve dokumentacionin teknik (planimetri dhe planvendosje) të nevojshëm për të vërtetuar pronësinë. Në rast se këto seksione nuk e disponojnë atë, me kërkesën e tyre Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, brenda datës 30 korrik 1993, të vërë në dispozicion me pagesë një kopje të dokumentacionit teknik për vërtetimin e pronësisë.

6. Për kthimin dhe kompensimin e trojeve të zëna me ndërtime të përhershme, seksioni i urbanistikës në rreth evidencon, brenda muajit korrik të vitit 1993, sipërfaqet e trojeve të lira pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese me specifikimet e nevojshme, si sipërfaqja, vendndodhja etj., dhe ia dërgon komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave të rrethit ose bashkisë.

Gjithashtu komiteti i zhvillimit të turizmit, brenda muajit shtator të vitit 1993, cakton sipërfaqet në zonat turistike në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme dhe ua dërgon komisioneve të rretheve e bashkive për t'i përdorur për kompensimin e ish-pronarëve.

7. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të marrë masat organizative e financiare për emetimin e obligacioneve sipas dispozitave në fuqi, nëpërmjet Bankës Shqiptare dhe, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, vendos për vleftat nominale të obligacionit, formën e tyre dhe mënyrën e përdorimit.

Obligacionet për kompensimin e ish-pronarëve të emetohen brenda muajit gusht 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi